



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2025

Lënda: Monitorimi i realizimit vjetor të buxhetit për vitin 2024.

MINISTRISË SË FINANCAVE

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Udhëzimit plotësues të ministrit të Financave nr. 1, datë 24.1.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën janar-dhjetor të vitit 2024.

Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2024 i janë akorduar fondet buxhetore, sipas shtatë programeve të miratuara për sistemin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, konkretisht:

- ❖ Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi
- ❖ Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit
- ❖ Mbështetja për Peshkimin
- ❖ Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes
- ❖ Zhvillimi xcRural
- ❖ Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor
- ❖ Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore

Buxheti vjetor fillestar është 14,180,500 mijë lekë, plani përfundimtar për vitin 2024 është 13,717,934 mijë lekë dhe i realizuar për periudhën paraqitet në shumën 13,067,503 mijë lekë ose 95.3% e planit përfundimtar.

Realizimet për shpenzime korrente janë 97.5%, investimet në total 88.5%, nga këto financimi i huaj 82.3%, Kosto Lokale 96%, T.V.Sh, 97.1 % dhe Investimet e brendshme 91.2%.


I detajuar realizimi vjetor i vitit 2024, sipas programeve paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Në milion/lekë

Emertimi i programit	Buxheti 2024	Struktura %	Fakti për vitin 2024		
			Fakti 2024	Realizim %	Struktura %
Planifikim Menaxhim Administrimi	460	3.35%	445	96.89%	3.41%
Siguria Ushqimore	2,421	17.65%	2,359	97.43%	18.05%
Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes	2,838	20.69%	2,646	93.21%	20.25%
Zhvillimi Rural	7,062	51.48%	6,723	95.19%	51.45%
Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	673	4.91%	639	94.91%	4.89%
Menaxhimi Qëndrushëm i Tokës Bujqësore	13	0.10%	13	97.53%	0.10%
Mbështetje për peshkimin	250	1.82%	243	97.15%	1.86%
TOTALI	13,718	100%	13,068	95.26%	100%

Në realizimin vjetor 2024, peshën më të madhe në nivelin e realizimit ndaj totalit, e zë programi buxhetor “Zhvillimi Rural” me 51.45% dhe pas tij programi “Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes” me 20.25 % “Siguria Ushqimore” me 18.05 % dhe “Siguria Ushqimore” me 18.05 %.

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për çdo program, sipas planit të buxhetit të vitit 2024 dhe realizimit faktik vjetore, paraqitet:



Monitorimi i shpenzimeve, sipas programeve

1- Programi 04250, “Zhvillimi Rural”

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2024, të programit “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë, blegtorisë, agroindustrisë dhe marketingut”, që përfaqëson **50.48%** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezultojnë si më poshtë:

• Shpenzimet korrente	98%
• Shpenzimet kapitale	82%
Gjithsej	95.2%

Programi buxhetor “Zhvillimi Rural në mbështetje të Bujqësisë Blegtorisë, Agroindustrisë dhe Marketingut”, për vitin 2024, kishte në dispozicion gjithsej **7,062 milion lekë**, nga të cilat:

- Shpenzime korrente 5,876 milion lekë, dhe
- Shpenzime kapitale 1,186 milion lekë

Ndryshimet thelbësore kanë konsistuar në alokimin e fondeve shtesë në financimin e skemave mbështetëse për bujqësinë, pakësimin e financimit të huaj.

Nga ana e institucioneve, pjesë e programit, për vitin 2024 janë marrë të gjitha masat për të realizuar aktivitetet e planifikuara në kohë dhe me cilësi, ndër të cilat rendisim:

- Miratimi i bazës ligjore për masat mbështetëse, të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2024 (VKM dhe Udhëzimi), si dhe urdhri për alokimin e fondeve sipas masave, bazuar në kërkesën e AZHBR-së;
- Miratimi i shtesës së fondit për skemën e grantave për investimet në fermë, si dhe ndryshimi i udhëzimit për efekt të datave të aplikimit;
- Aplikuar rreth 15,597 aplikantë në skemat kombëtare, si dhe 54,255 aplikantë në mbështetjen me naftë për bujqësinë;
- Disbursuar për vitin 2024 fondet për 67,132 përfitues: 14,937 përfitues nga skema kombëtare, si dhe 52,195 nga skema e subvencionimit e naftë për bujqësinë;
- Nga numri total i përfituesve kemi rreth 2,425 gra nga skema kombëtare, si dhe 5,043 gra, nga skema e subvencionimit me naftë për bujqësinë;
- Financuar 40 subjekte, nga të cilat 11 gra, përmes thirrjeve të programit IPARD II;
- Degustimi i rreth 131 mostrave të duhanit dhe analizuar 189 puro/duhan i grirë dhe cigare të gjeneratës së re;
- Promovuar bizneset dhe produktet shqiptare në 9 aktivitete ndërkombëtare dhe kombëtare;
- Kryer vërtetimi statistikor për vitin 2024, agroindustrinë, si dhe mbjelljet e vjeshtës;
- Vlerësuar dhe rregjistruar tre produkte nën skemat e cilësisë me emërtimin STG (Specialitet Tradicional i Garantuar), si dhe miratuara ndryshimet e specifikimeve për një produkt të rregjistruar si STG;
- Rregjistruar rreth 350 njësi vreshti dhe 13 857 njësi ulliri;
- Në fazë implementimi aktivitetet nga Projektet e Huaja, etj.

Gjatë vitit 2024, u përgatitën materialet për pozicionin negociues dhe planin e veprimit për Kapitullin 11, të cilat u dorëzuan pranë Ministrisë të Shtetit për Integrimin dhe Kryenegociator.

Brenda programit është ndjekur dhe monitoruar dhe indikator i lidhur me planifikimin gjinor, ku janë reflektuar të dhënat referuar indikatorëve përkatës. Lidhur me këtë aspekt, gjatë kësaj periudhe në bashkëpunim me koordinatorin gjinor në ministri, janë organizuar disa takime me ekspertët e QTTB-së Fushë Krujë, për hartimin e planit të punës dhe fillimin e procedurave të monitorimit.

Po ashtu lidhur me kadastrat janë kryer një sërë aktivitetesh kryesisht për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të ri lidhur me vreshtarinë dhe verën, si dhe detyrimet që kanë grupet e përfshira në raportimet përkatëse.

Programi rezulton me 94.4 % realizim të fondeve të planifikuara.

Ecure e disa produkteve kryesore:

Masat mbështetëse. Gjatë vitit 2024 është rishikuar baza ligjore dhe nënligjore përkatëse. Me VKM nr. 581, datë 18.09.2024 “Për disa shtesa në vendimin nr. 130, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2024” është miratuar fondi shtesë prej 1,500 milion lekë për investime në fermë, nga të

cilat u planifikuan 500 milion lekë për vitin 2024, por pas rishikimit të buxhetit me Aktin Normativ të fundvitit u reduktua dhe u bë 100 milion lekë për vitin 2024. Fondi total për masat e mbështetjes ka qenë në masën 5.3 miliardë lekë, nga 3.4 miliardë lekë të planifikuara në fillim të vitit. Po ashtu, është ndryshuar udhëzimi i përbashkët i skemës kombëtare, bazuar në ecurinë e aplikimeve dhe lehtësimin e kushteve për fermerët aplikantë. Në skemën kombëtare kanë aplikuar rreth 15,597 aplikantë dhe janë disbursuar fondet për 14,937 përfitues ose 95.8% e aplikimeve. Fondi total i disbursuar ka qenë 2,907,818,433 lekë. Disbursimi më i madh i fondeve ishte tek masa Nr. 2, “Mbështetje për tufën bazë të matrikulluar, krerë/dele/dhi” me rreth 41.3% të fondit të disbursuar, ndjekur nga masa Nr. 1 “Mbështetje për tufën bazë të matrikulluar, krerë/lopë”, me rreth 24.9%, tek masa Nr. 3 “Mbështetje për mbarështimin e bletarisë”, me rreth 14.3%, si dhe tek masa Nr. 4 “Mbështetje për fara/fidanë dhe inpute të tjera”, me rreth 7.9% të fondit të disbursuar. Po ashtu në këto masa ka qenë dhe numri më i lartë i aplikimeve dhe përfituesve. Për masën 5 “Bimë mjekësore dhe aromatike” disbursimi ka qenë rreth 4.9% e totalit të disbursuar. Për SHBB dhe grupet e fermerëve financimi ka qenë në masën 178,192,840 lekë ose 6.12% e fondit.

Për skemën e investimeve disbursimi ka qenë në masën 11,449,415 lekë.

Skema e subvencionimit me naftë për mekanizimin në bujqësi. Në këtë skemë numri i aplikimeve ka qenë rreth aplikimit, me rreth 54,226 aplikime në total dhe është disbursuar një fond prej 2,282,592,198 lekë për 52,195 përfitues, nga të cilë rreth 9.7% ose 5,043 kanë qenë gra.

Vlen të theksohet se numri i përfituesve gra nga skema mbështetëse ka qenë rreth 11.1% e numrit total të përfituesve, ku përmes strukturave të ekstensionit bujqësor, transferimit të njohurive, takimeve informuese është bërë i ndërgjegjësimit të grave.

Aktivitete promovuese. Gjatë vitit 2024 është mundësuar pjesëmarrja në 9 aktivitete promovuese ndërkombëtare dhe kombëtare. Përfaqësimi në këto aktivitete ka qenë shumë i kënaqshëm duke mundësuar njohjen e Shqipërisë dhe produkteve shqiptare, si dhe duke krijuar një qëndrueshmëri dhe stabilitet të subjekteve pjesëmarrësve, për të mundësuar në fund krijim kontaktesh dhe lidhje kontratash. Ndër panairët ndërkombëtare përmendim pjesëmarrjen në panairin Fruit Logistica në Gjermani (panairi më i rëndësishëm tregtar në botë për biznesin e produkteve të freskëta, ku mbledhen së bashku vizitorë e tregtarë dhe miq nga e gjithë bota për të krijuar lidhje produktive). Një tjetër panair ndërkombëtar ka qenë: Global Albanian Gastronomy Festival, organizuar në Berlin.

Mostra të degustuara të duhanit për ruajtjen e shëndetit të konsumatorëve. Aktivitetet për realizimin e këtij produkti ndiqen nga Agjencia Kombëtare për Duhan Cigaren. Gjatë vitit 2024, AKDC ka vijuar punën me realizimin e kontrollit të duhaneve dhe produkteve të tij sipas kërkesave të Komunitetit Europian në mbështetje të qëllimit të OBSH për ruajtjen e shëndetit të konsumatorit, me rreth 131 mostrave të duhanit dhe analizuar 189 puro/duhan i grirë dhe cigare të gjenratës së re, me një realizim 100%. Po

ashtu është kryer shpërndarja e teknologjive, rekomandimeve, broshurave për prodhimin dhe teknologjinë e tharjes dhe ruajtjes së prodhimit të duhanit deri në dorëzim prodhimi të farërave, strukturën varietore dhe rajonizimin, si dhe azhurnimin e tyre me kërkimin shkencor. AKDC ka punuar në drejtim të orientimit të prodhuesve për rritjen e sipërfaqes së duhanit në vend, përmes këshillimit dhe materialeve divulgative për të pesë fazat, në të cilat kalon prodhimi i duhanit. Gjithashtu është kryer procedura e prokurimit për blerjen e GasCromatograf (GC) me qëllim përcaktimin e parametrave kryesorë që përcaktohen në legjislacionin shqiptar për prodhimin, tregtimin dhe mbrojtjen e konsumatorit nga produktet e duhanit.

Vrojtime statistikore. Gjatë vitit 2024, në bashkëpunim, me INSTAT dhe Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, janë realizuar në masën 100%, sipas afatit, aktivitetet statistikore, si më poshtë:

- Vrojtimi Vjetor Bujqësor 2023;
- Vrojtimi i Sipërfaqeve të mbjella, Qershor 2024;
- Vrojtimi i subjekteve të Agroindustrisë;
- Vrojtimi Vjetor Bujqësor 2024.

Njësi vreshti dhe ullishte të rregjistruara. Programi “*Përditësimi i Kadastrës së Vreshtit*” ka si qëllim përditësimin e databazës (të dhënave) në regjistrin e Vreshtit, regjistrin e kantinave të verës, sensibilizimin e specialistëve, fermerëve, subjekteve prodhues, grumbullues dhe përpunues të rrushit me ligjin Nr. 86/22 Për “*Vreshtarinë dhe verën*”. Për kadastrën e vreshtit, për vitin 2024 është arritur:

- identifikimi, regjistrimi dhe dixhitalizimin në Quantum GIS i të dhënave për 350 njësi të reja vreshti, ose 50 njësi vreshti mbi planin në njësitë administrative Qendër, Vëndreshë, bashkia Çorovodë të bashkisë Çorovodë qarku Berat;
- Identifikimi i 348 parcelave nën 1000m² të kultivuara me vreshta me sipërfaqe totale 16.95ha;
- Informimi i 172 specialistëve të Sektorëve të Ekstensionit Bujqësor në 12 qarqe të vendit me Ligjin Nr. 86/22 Për “*Vreshtarinë dhe Verën*” dhe akteve nënligjore përkatëse;
- Përditësimi i bazës së të dhënave për fabrikat e prodhimit të verës në qarkun Berat.

Përditësimi i Kadastrës së Vreshtit ofron informacion për të ndërhyrë me politika mbështetëse sektoriale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të gjurmshmërisë dhe kontrollit cilësor të produkteve, për prodhuesit e verës, informacion mbi tregun lokal si faktor i rëndësishëm për vendimarrjet dhe investimet.

Programi “*Krijimi i Kadastrës së Ullirit*” është implementuar në njësitë administrative: Cakran dhe Frakull të bashkisë Fier, Hekal të bashkisë Mallakastër, Ballagat, Hysgjokaj dhe Golem (vazhdim) të bashkisë Lushnjë dhe në njësinë administrative Novoselë të bashkisë Vlorë. Gjatë vitit 2024 janë arritur këto rezultate:

- Studim fushor, identifikimi, regjistrimi i të dhënave dhe dixhitalizimi në programin e Kadastrës së Ullirit të 13,857 njësive të reja ulliri, ose 857 njësi ulliri mbi objektivin e planifikuar;
- 22 specialistë të trajnuar në Sektorin e Ekstensionit Bujqësor të qarkut Fier, ZMMT në njësitë administrative për interpretimin e regjistrit dhe mbajtjen e kontaktit të vazhdueshëm me QTTB Fushë Krujë për raportimin e të dhënave dhe pasqyrimin e ndryshimeve që ndodhin;
- Regjistra dhe harta të vendodhjes për çdo njësi administrative, manuale e elektronike, për njësitë e ullirit, për subjektet përpunuese dhe tregëtuese të vajit e të ullinjve të tavolinës, dorëzimi i tyre pranë SEB, Fier;
- Raport studimi mbi gjendjen dhe perspektivën e zhvillimit të ullirit për njësitë administrative në qarkun Fier dhe Vlorë, dorëzimi i tyre pranë SEB Fier;
- Regjistrimi i fabrikave prodhues të vajit, teknologjisë të përdorur dhe kapacitetit përpunues të këtyre subjekteve në bashkitë Mallakastër, Fier, Lushnjë dhe Roskovec.

Krijimi i Kadastrës së Ullirit ofron informacion për të ndërhyrë me politika mbështetëse sektoriale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të gjurmueshmërisë dhe kontrollit të cilësisë së vajit, për përpunuesit dhe tregëtarët e vajit të ullirit dhe ullinjve të tavolinës ofron informacion mbi tregun lokal si faktor i rëndësishëm për vendimmarrjet dhe investimet.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikimeve për EOM, TGJM dhe STG. Gjatë vitit 2024 nga struktura përgjegjëse në Ministri për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, janë realizuar katër takime konkretisht për:

- Miratimin e ndryshimeve të specifikimeve të produktit të rregjistruar me STG (Specialitet Tradicional i Garantuar), “Mjalti i Bedunicës”, Përmet, Gjirokastrë;
- Rregjistrimi i produktit “Kumbulla e thatë e Shumbatit”, Dibër, si STG;
- Rregjistrimi i produktit “Gliko e Arrës”, Përmet, Gjirokastrë, si STG;
- Vlerësim për Vaj Ulliri Valmi, Elbasan;

Po ashtu është kryer dhe një takim i komisionit të vlerësimit për prodhimin organik.

Ruajtja e racave autoktone në buaj dhe bagëti të imta. Për këtë produkt në programin 04250 “Zhvillimi Rural në mbështetje të prodhimit bujqësor, blegtoral, agroindustrisë dhe marketingut”, nuk ishte parashikuar fond në aparatin e Ministrisë për ruajtjen e racave autoktone dhe përmirësimin racor (pasi nga EMP ishte kërkuar kalimi i këtij zëri në Programin e Sigurisë Ushqimore). Me kërkesë të AREB Lushnjë dhe legjislacioni përkatës u bë alokimi i një fondi prej 1,240,000 lekë për mbështetje financiare për rezervën gjenetike të racës autoktone të buajve.

Popullim të dhënash për regjistrin e fermës. Ky fond nuk u përdor në këtë aktivitet pasi u angazhuan direkt ekspertët e Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor. Fondi u la i lirë dhe u përdor nga aparati i MBZHR për kryerje pagesash të ndryshme.

Përfitues nga programi IPARD II. Viti 2024 ishte dhe vitit i fundit i zbatimit të Programit IPARD II. Gjatë vitit 2024 janë paguar 37 investime të plota/të përfunduara dhe 3 procedura/aktivitete të kryera në kuadër të masës 9 – Asistenca Teknike. Në total janë disbursuar 508,691,440 lekë. Nga 37 subjekte përfituese 11 janë gra dhe 19 përfitues janë fermerë të rinj, nën 40 vjeç.

Janë disbursuar:

- 16 subjekte në masën nr. 1, përkatësisht: 9 në sektorin e fruta - perimeve, 4 në sektorin e qumështit; 2 në vreshtari, si dhe 1 në sektorin e mishit;
- 2 subjekte në masën nr. 3, në sektorin e përpunimit të fruta – perimeve; si dhe
- 19 subjekte në masën nr. 7, në turizëm rural;
- 3 aktivitete në masën nr.9 – Asistenca Teknike.

Për projektin **GIZ, “Zhvillimi i Qëndrueshëm në Zonat Rurale në Shqipëri”**, disbursimet kanë qenë në masën 350,326,160 lekë. Me fondet e planifikuara për financimin e brendshëm është paguar TVSH në masën 22,386,918 lekë.

Projekti “Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë”, financuar nga Banka Botërore, realizimi i të cilit gjatë vitit 2024 arriti në vlerën 52,326 mijë lekë, duke përfshirë edhe Front & Fee në vlerën 16,763 mijë lekë, me një shkallë realizimi prej 45%. Nga ky projekt për vitin 2024 u mundësua investimi i pajisje si:

- Panelet diellore për ISUV, një investim kyç për eficiencën energjetike dhe qëndrueshmërinë e institucionit.
- Pajisje kompjuterike dhe mobilje për zyrat e PMT-së, duke modernizuar infrastrukturen administrative.
- Blerja e një automjeti për PMT-ne, për të siguruar lëvizshmëri dhe mbështetje logjistike në terren, rrethe ku shtrihet aktiviteti i projektit.

****Sqarim: Në sistemin AFMIS, shpenzimet faktike për këtë projekt janë 18,798,860 lekë, pra nuk janë përfshirë shpenzimet Front&Fee****

Projekti IDELE - ka patur realizim prej 900 lekë.

Projekti Food4Health - ka patur realizim prej 2,540,060 lekë.

Projekti “Për luftimin e grerëzës së gështenjës” - Kosto lokale për këtë projekt, në zbatim të marrëveshjes me FAO-n, është shtuar me Aktin Normativ të fundvitit në kuadër të marrëveshjes së lidhur me MBZHR-së dhe FAO-s, realizimi i investimit është 4,875,000 lekë ose 97.5% e buxhetit të alokuar.

TVSH Bashkefinancim projekte Aparat - Asistenca Teknike – Fondi prej 3,000,000 lekë, është përdorur për pagesën e TVSH-së, referuar Urdhrit Nr. 1113, datë 20.12.2024.

Projekte investimesh të brendshme. Në investimet e brendshme janë përfshirë investimet direkte për institucionet e varësisë, si dhe bashkëfinancimi për projektet e huaja që operojnë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural nën këtë program. Gjatë vitit 2024 janë kryer procedurat dhe disburuar fondet për blerje pajisje kompjuterike për AZHBR në vlerën 6,084,720 lekë.

2. Programi 04220, “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit”

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2024, në këtë program, që përfaqëson 18% të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet 97.7%
- Investimet 95.1%
- Gjithsej 97.4%**

Politika në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit synon përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së, hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të kontrollit të sëmundjeve në kafshë e dëmtuesve në bimë, programeve të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe në produktet ushqimore me origjinë shtazore, monitorimit të ujërave e molusqeve bivale, identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, forcimin e karantinës veterinarë e fitosanitare, përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve, fuqizimin e rrjetit laboratorik, fuqizimin e inspektimeve mbi sigurinë ushqimore, vendosjen e sistemit të vetëkontrollit dhe informimin në kohë të konsumatorit.

Për vitin 2024 u realizuan aktivitetet mbi masat profilaktike veterinarë dhe fitosanitare, programi i monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore, monitorimi i ujërave e molusqeve bivalve, monitorimi i dëmtuesve në bimë e produkte bimë, identifikimi i kafshëve dhe hedhja e të dhënave në sistemin e informacionit blegtoral dhe veterinar RUDA, luftimi i dëmtuesve në bujqësi dhe mbështetja e të gjithë aktiviteteve të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes të Bimëve (AKVMB), Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) me 12 Drejtoritë Rajonale të AKU, si dhe analizimi, testimi dhe certifikimi i farave dhe fidanëve të certifikuar nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.

Produktet e përfituara, parashikuar në PBA-në e vitit 2024, janë realizuar si më poshtë:

- 90502AA “Kafshë të vaksinuara dhe të gjurmua”: Ky zë është realizuar në masën 96%. Vaksinimi është një proces në zbatim të strategjisë së miratuar dhe kryhet me vaksinë të blerë që mbulohet nga buxheti i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR). Janë vaksinuar gjithsej **112,477** krerë kafshë nga të cilat **44,425**

krerë janë vaksinuar kundër sëmundjes të Brucelozës dhe **68,052** krerë janë vaksinuar kundër sëmundjes të Plasjes. Për vitin 2024, janë gjurmuar në total **167,988** krerë gjedhë për Tuberkulozin dhe Brucelozën. Në këtë zë janë përfshirë edhe shpenzimet veterinare të Drejtorive Rajonale të AKVMB (blerja e bazës materiale, certifikatat që lëshohen në thertore, baza materiale për sistemin RUDA, blerja e dezinfektantëve, dërgimi i mostrave në ISUV dhe dëmshpërblimi i **443** kafshëve të ngordhura ose të eliminuara me sëmundjen e plasjes, tuberkulozit dhe brucelozës).

- 90502AB “*Kafshë të shëndetshme dhe të kontrolluara*”: Ky zë është realizuar në masën 99%. Janë realizuar kontrole në fermat e kafshëve të gjalla si dhe kontrole në farmacitë veterinare dhe depot farmaceutike, në total janë realizuar rreth **14,589** kontrole në terren. Janë realizuar dhe shpenzimet paga + sigurime (600+601), shpenzime korrente (602) dhe kapitale të pa trupëzuara (606) nga AKVMB.
- 90502AC “*Matrikuj të blera për kafshët*”: Ky zë është realizuar në masën 89%. Me fondin prej **24.8** milionë lekë, janë blerë në total **462,040** matrikuj për kafshët e llojit gjedhë dhe të imta. Fondet e tjera u përdorën për nevoja të programit Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit.
- 90502AD “*Analiza të kryera në kuadër të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale*”: Ky zë është realizuar në masën 97%. Janë analizuar **377,358** kampione nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, kampione të dërguara nga veterinerët zyrtar, inspektorët e AKU dhe operatorët e biznesit të cilët eksportojnë drejt vendeve të BE-së dhe më gjerë. Është kryer mirëmbajtjen e **1,631** testeve laboratorike dhe është realizuar zgjerimi i akreditimit me **278** parametra analitikë duke e rritur numrin e akreditimeve me **1,909** parametra dhe teste analitike. Janë realizuar dhe shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (600+601), shpenzimet për mallra dhe shërbime (602), investimet e brendshme dhe transfertat për familjet dhe individët (606).
- 90502AE “*Emergjenca veterinare dhe emergjenca për sigurinë ushqimore*”: Ky zë mbahet në aparatin e MBZHR dhe përdoret për nevoja që dalin gjatë vitit për tre institucionet e vartësisë, AKU, AKVMB dhe ISUV. Për vitin 2024, në total janë dëmshpërblyer **443** kafshëve të ngordhura ose të eliminuara me sëmundjen e plasjes, tuberkulozit dhe brucelozës me një vlerë prej 62.1 milionë lekë të cilat janë paguar nga zëri 90502AA.
- 90502AF “*Fara dhe fidanë të analizuara, testuar dhe certifikuar*”: Për periudhën janar - dhjetor 2024 janë kryer **239 analiza** të cilat kanë qenë për të përcaktuar fuqinë mbirëse, testin e pastërtisë, testin e lagështirës si dhe analiza në kuadër të vetëkontrollit. Janë certifikuar **230,800 fidanë frutorë, 25,086,750 fidanë perimor, 190,495 fidanë dekorativ, 7,465 kv** (fara patate, foragjerë dhe misri) si dhe janë **testuar 48 varietete** të reja.
- 90502AG “*Inspektimi dhe menaxhimi i riskut në fushën e sigurisë ushqimore*”: Ky zë është realizuar në masën 98%. Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU) kanë realizuar për vitin 2024 në të gjithë territorin e vendit **111,785** inspektime. Për vitin 2024 sektorët e shërbimeve laboratorike të AKU kanë

pranuar në total **6,775** mostra të cilat janë analizuar për **13,174** tregues analitik si dhe në kuadër të planit të monitorimit të qumështit lëndë e parë laboratorët e AKU kanë pranuar në total **5,507** mostra. Janë realizuar dhe shpenzimet paga + sigurime (600+601), shpenzime korrente (602)(606) dhe kapitale të pa trupëzuara (231).

- 90502AI “*Funksionimi i Autoritetit Kombëtar Veterinar dhe Mbrojtjes të Bimëve*”: Ky zë është realizuar në masën 100%. AKVMB ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit dhe ka fushë përgjegjësie shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve. Drejtoria e Mbrojtjes të Bimëve dhe Drejtoria e Veterinarisë në Drejtorinë e Përgjithshme të AKVMB, për vitin 2024 ka kryer **798** inspektime dhe mbikëqyrje në terren.

Ecuria e investimeve të brendshme për programi 04220 për vitin 2024 paraqitet si më poshtë:

- Projekti me Kodin I8AJ402 “*Pajisje Speciale për Grupet e Inspektimit*”, në vlerë 1,120,000 lekë, vlera e realizuar është në masën 1,111,200 lekë, 99%.

Nga ky projekt u përfituan pajisjet e mëposhtme për grupet e inspektimit të AKU-së me:

- | | |
|---|---------|
| 1. Termometër për matjen e temperaturës në thellësi | 13 copë |
| 2. Frigoboks professional. 30 litër | 3 copë |
| 3. Frigoboks professional. 15 litër | 9 copë |

- Projekti me Kodin I9AB608 “*Blerje Pajisje Kompjuterike*”, në vlerën 580,000 lekë. Projekti është realizuar në vlerën e kontratës 577,696 lekë, 100%. Nga ky projekt u përfituan pajisjet kompjuterike për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së me 6 kompjutera.
- Projektin me Kodin I9AB606 “*Blerje Pajisje Zyre (Mobilie Zyre)*”, në vlerën 950,000 lekë. Projekti është realizuar në vlerën e kontratës 946,800 lekë, 100%. Nga ky projekt u përfituan pajisjet e zyrave për Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së me karrige dhe rafte për dokumenta.
- Projektin me Kodin I9AB607 “*Blerje Pajisje Zyre (Kondicioner për DRAKU Tiranë)*”, në vlerën 810,000 lekë. Projekti është realizuar në vlerën e kontratës 809,760 lekë, 100%. Nga ky projekt u përfituan pajisjet e zyrave me 14 *Kondicioner* për Drejtorinë Rajonale të AKU-së, Tiranë.
- Në lidhje me projektin me kod 24AD701 “*Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV në të tre fushat ku ushtron aktivitetin e tij analitik, siguri ushqimore, shëndet kafshësh dhe bimësh*” është lidhur kontrata me OE fituese në datë 16.09.2024 me vlerë 189,336,000 lekë si edhe realizuar nga OE është likuiduar në vitin 2024 vlera 81.329.000 lekë dhe diferenca prej 108,007,000 lekë pritet të likuidohet në vitin 2025. Nga ky projekt u mudësua blerja e 18 pajisjeve laboratorike të cilat kanë synim rritjen e prodhimit dhe eksporteve, sigurisë ushqimore, zhvillimit rural dhe peshkimit si edhe nga dinamika e lartë

e ndryshimit të standardeve, metodave të analizimit si dhe përcaktimit të Limiteve të lejuara nga standardet dhe rregulloret e BE-së të jetë në mbështetje të:

- Kërkesave në rritje dhe forcimit të besueshmërisë ndaj eksporteve Shqiptare;
- Zinxhirit të vlerës, forcimit të sigurisë dhe cilësisë ushqimore;
- Aplikimit të metodave të avancuara lidhur me parandalimin dhe përgjigjen në kohë ndaj situatave emergjente gjatë epidemive të ndryshme, programeve të kontrollit në funksion të institucioneve ligj zbatuese.

Projektin me Kodin 18AJ104 “*Rikonstruksioni zyrave të Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes të Bimëve Vlorë*” në vlerë 4,900,000lekë, vlера e realizuar është ne masën 4,900,000 lekë ose e shprehur në përqindje 100%, për vitin 2024. Gjithashtu ky projekt vijon edhe në vitin 2025

3. Programi 04240, “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin e vitit 2024, për këtë program, që përfaqëson **17.8%** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korrente	97.6%
• Shpenzimet kapitale	91%
Gjithsej	93.2%

Ecuria progresive e këtij programi, rezulton:

Për Investimet e brendshme, në total janë financuar 97 projekte nga të cilët 27 projekte kanë përfunduar (kryesisht projektet në vazhdim nga vitit 2023) dhe 70 projekte vazhdojnë financimin me shtrirje kryesisht në vitet 2025-2026.

Nga totali i projekteve:

- 56 projekte me vlere 1412.7 milion leke i përkasin infrastrukturës në administrim të 4 DUK-ve;
- 41 projekte me vlerë 477.3 milion lekë i përkasin infrastrukturës në administrim të Bashkive.

Realizimi në masën 91% i investimeve për vitin 2024, ka ardhur kryesisht nga pamundësia e realizimit të punimeve në projektet e bashkive, sidomos në projektet, që u financuan muajin tetor te vitit 2024, me VKM Nr. 559, datë 11.9.2024 “*Për një ndryshim në Vendimin Nr. 226, datë 9.4.2024, të Këshillit të Ministrave “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”*”.

Investimet janë adresuar në aktivitet si më poshtë (sipas realizimit faktik):

• Totali	1720 milion lekë
• Për infrastrukturën e ujitjes	786 milion lekë
• Për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja	688 milion lekë
• Për rehabilitim e hidrovoreve	105 milion lekë
• Paisje mekineri	141 milion lekë

Impakti për vitin 2024:

- Në ujitje, përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes në rreth 10,000 ha ha, kryesisht nga përfundimi i reabilitimit të disa kanaleve kryesor ujtes në administrim të DUK-ve, si kanali Polis -Tudan në bashkinë Elbasan, Peqin-Kavajë në bashkitë Peqin, Rrogozhinë dhe Kavajë, Magjistrali Mat-Lezhe në bashkinë Lezhë, Shtodër në bashkinë Malësi e Madhe etj.;
- Në mbrojtje nga përmbytja, rehabilitimi/ndërtimi i rreth 12 km argjinatura për mbrojtjen nga përmbytja dhe gërryerja të tokave bujqësore dhe zonave të banuara, me rrisht të lartë, kryesisht në lumenjtë Drin, Buna, Kir, bashkia Shkodër, Vermosht bashkia Malësi e Madhe, Osum në bashkitë Dimal dhe Berat; Devoll në bashkinë Cërrik; Erzen, në bashkinë Tiranë, Vjosa në bashkinë Fier, Shkumbin në Peqin, Kalasë në bashkinë Delvinë dhe Sarandë, Drinos në bashkinë Gjirokastrë. Gjithashtu është rikonstruktuar edhe argjinatura e Torovicës në bashkinë Lezhë, që ndan fushën e nënShkodrës me ish kënetën e Torovicës;
- Në hidrovore, ka përfunduar rehabilitimi i hidrovoreve Akërnë në bashkinë Vlorë dhe Karavasta në bashkinë Divjakë, që përmirësojnë kullimin në rreth 11,000 ha si dhe ka filluar rehabilitimi i hidrovorit të Grethit dhe Syneit në bashkitë Rrogozhinë dhe Kavajë si dhe hidrovori Hamallj në bashkinë Durrës;
- Blerja e 4 ekskavatoreve të rinj krahë gjatë dhe 1 rimorkjatori për transportin e ekskavatorëve të DUK-ve.

Me shpenzimet operative është mundësuar:

- Mirëmbajtja/përmirësimi i kullimit në rreth 60,000 ha (si proces ciklik i mirëmbajtjes vjetore), nëpërmjet lëvizjes së rreth 2 milion m³ dhera (në rreth 270 km kanale kryesor);
- Mirëmbajtja e rrjetit të kanaleve kryesor ujtes dhe veprat e marrjes (kryesisht në ultësirën perendimore) dhe është mundësuar furnizimi me ujë i rrjetit ujtes sekondar në administrim të bashkive për një sipërfaqe ujtes rreth 100,000 ha si dhe janë lëvizur rreth 300,000 m³ dhera nga knalet kryesor ujtes.
- Remonti i elektropompave dhe panave elektrike në 27 hidrovore dhe është garantuar funksionimi me kapacitet të plotë të tyre, sidomos në situatat me reshje intensive.

4. Programi 04860, “Këshillimi dhe Informacioni bujqësor”.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2024, për këtë program që përfaqëson rreth 5.1% të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korente	94.8%
• Shpenzimet kapitale	99.5%
Gjithsej	94.9%

Në programin “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor”, përfshihet financimi i aktivitetit të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, të cilat ndiqen nga sektorët përkatës.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), gjatë vitit 2024 e kanë përqëndruar aktivitetin e tyre në realizimin e detyrave të planifikuara sipas programit të punës të miratuar, për këtë vit.

Produktet e parashikuara të këtij programi janë realizuar si vijon:

Produkti 90506AA: “Paketa dhe karta teknologjike të prodhuara nga 5 QTTB-të, që ju vihen në dispozicion fermerëve dhe agrobizneseve dhe aplikohen prej tyre”. Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt, në përfundim të vitit 2024, janë realizuar në masën 93% krahasuar me planin vjetor të rishikuar të shpenzimeve. Për vitin 2024, ishin planifikuar për t’u realizuar 16 teknologji/paketa teknologjike (elementë të përmirësuar). Aktivitetet që i shërbejnë *Produktit 90506AA* janë studime, teknika dhe teknologji në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, testime, mirëmbajtje dhe rigjenerime të koleksioneve gjenetike, që përdoren për përmirësimin e komponentëve prindëror të farërave dhe fidanëve si dhe prodhimin e hallkave të larta që u ofrohen fermerëve me çmime konkurruese.

Produkti 90506AB: “Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore funksionale”: Shpenzimet për këtë produkt, në përfundim të vitit 2024, janë realizuar në masën 90 %. Shpenzimet për këtë produkt i dedikohen përmbushjes së detyrave funksionale të QTTB-ve dhe janë shpenzime që realizohen të ndara në financimin e Projekteve dhe Financimin Institucional.

Produkti 90506AC: Gra të informuara dhe trajnuara nga shërbimi këshillimor publik. Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, për vitin 2024 kishin planifikuar për të realizuar 5 ditë trajnimi të dedikuara për 500 gra fermere, me synim zbutjen e parabarazisë dhe integrimin gjinor. Këto trajnime u realizuan gjatë 4 mujorit të III-të të vitit, me përjashtim të trajnimit të planifikuar nga QTTB Fushë Krujë, i cili për arsye objektive nuk u realizua.

Produkti 90506AD: Fermerë të asistuar nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor për aplikimet në skemat kombëtare dhe IPARD. Përgjatë fushatave promovuese dhe

periudhave të aplikimit për skemat përkatëse, janë asistuar rreth fermerë 76,647 aplikantë nga 71,537 të planifikuar.

Produkti 90506AE: Fermerë të kontaktuar dhe ofruar shërbime ekstensionit. Aktivitetet që shërbejnë për realizimin e këtij produkti janë: 17 kërkime në nivel ferme që realizohen nga QTTB-të në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit të Ekstensionit, në ferma të ndryshme në të gjithë territorin e vendit; trajnime nga QTTB-të, Universiteti Bujqësor dhe Projekte që veprojnë në fushën e bujqësisë në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve për specialistët e Ekstensionit dhe këta të fundit në përmirësimin dhe freskimin e njohurive të fermerëve të interesuar. Nga 151 ditë trajnimi për specialistët e shërbimit këshillimor të planifikuar, gjatë vitit 2024, janë realizuar 182 ditë trajnimi. Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor kanë qenë të angazhuar në informimin e komunitetit të fermerëve dhe agrobizneseve në lidhje me mundësinë e përfitimit nga Skemat Kombëtare të Mbështetjes 2024, si dhe në asistimin dhe zbatimin e Skemës së naftës për bujqësinë në vitin 2024, duke mbështetur dhe ndihmuar drejtpërdrejt rreth 76,647 aplikantë.

Lidhur me Investimet e Brendshme për Qendrat e Transferimit të Tekologjive Bujqësore dhe Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësorë, ishin të parashikuara investimet e mëposhtme:

Produkti M050419 “Pajisje laboratorike të blera nga QTTB Fushë Krujë” - Produkti është realizuar në masën 100% në sasi fizike.

Produkti 18AL619 “Traktor frutikulture i blerë nga QTTB Vlorë” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti 18AL620 “Pajisje laboratorike të blera nga QTTB Lushnje” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti M051025 -Studime projektme Kateg.230 (Projektim) - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti 18AL524 “Magazinë e rikonstruktuar nga QTTB Korçë” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti 18AL616 “Agregat bujqësor i blerë nga QTTB Shkodër” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti M050778 “Pajisje kompjuterike të blera nga AREB Tiranë” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti 18AL404 “Pajisje kompjuterike të blera nga AREB Korçë” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti 18AL405 “Pajisje kompjuterike të blera nga AREB Shkodër” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti 18AL406 “Blerje pajisjesh kompjuterike nga AREB Lushnje” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti 18AL408 “Kondicionerë të blerë nga AREB Shkodër” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti 18AL409 “Pajisje zyrash të blera nga AREB Korçë” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti 18AL4010 “Kondicionerë të blerë nga AREB Tiranë” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Produkti M050392 “Blerje pajisje zyrash nga AREB Lushnje” - Objekti i investimit është realizuar 100% në sasi fizike.

Shërbimi i Ekstensionit

Gjatë vitit 2024, Strukturat e Ekstensionit (Shërbimit Këshillimor) në 4 Agjensitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor kanë qenë të pranishme dhe kanë zhvilluar aktivitete ekstensionit si demonstrime, ditë fushe, takime të tjera në grup, seminare, panaire, tavolina të rrumbullakëta etj. Këto aktivitete, kanë si synim përmirësimin e shprehive praktike dhe njohurive të fermerëve.

Nga strukturat e Shërbimit Këshillimor u kontaktuan direkt dhe indirekt dhe morën informacion gjithësej rreth 131,896 fermerë dhe agrobiznese (nga të cilët 6,404 janë gra fermere) nga 100,000 fermerë dhe agrobiznese të synuara.

Gjatë vitit 2024, u realizuan 182 ditë trajnime të hapura me specialistë të bujqësisë ose 3,066 ditë/ekstensionistë të trajnuar nga 151 ditë trajnimi të planifikuara, si dhe 2,102 ditë trajnime me fermerë, me pjesëmarrjen e 15,047 fermerëve të interesuar, kryesisht për çështje teknike, ekonomike, të kooperimit, marketingut, për ndryshimet klimatike etj.

Janë realizuar 1,088 demonstrime me pjesëmarrjen e rreth 7,949 fermerëve, 167 ditë fushe me pjesëmarrjen e 1,298 fermerëve, janë shpërndarë për të interesuarit 38,793 copë fletëpalosje për probleme të ndryshme të teknologjisë në bimë e kafshë, kooperimit bujqësor, menaxhimit të integruar të fermës, marketingut, etj.

Janë realizuar 119 kronika dhe emisione televizive në TV lokale.

Gjatë këtij viti ishin planifikuar u realizuan edhe 5 broshura divulgative me titujt më të kërkuar nga fermerët dhe specialistët e bujqësisë.

Informacion mbi performancën e produktit 90506AC: “Gra të informuara dhe trajnuara nga shërbimi këshillimor publik”

Në përputhje me parimin e barazisë gjinore të përcaktuar në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, programet buxhetore kanë detyrimin të përcaktojnë të paktën një objektiv me bazë gjinore, të shoqëruar me tregues performance në nivel objektiv dhe produkti.

Në këtë kuadër, në Qëllimet e Politikës së Programit Buxhetor 04860 “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor” ishte përcaktuar dhe kostuar një produkt me bazë gjinore në vlerën 2.3 milion lekë, i cili synoi ofrimin e trajnimeve specifikuara për gratë fermere, me qëllim rritjen e aksesit në informacion dhe zbutjen e pabarazisë gjinore.

Trajnimet u zhvilluan në Badëlonjë, Përmet (organizuar nga QTTB Vlorë); Kuqan, Elbasan (organizuar nga QTTB Lushnjë); Koplik, Malësi e Madhe (organizuar nga QTTB Shkodër), si dhe në Divjakë (organizuar nga QTTB Korçë).

Tematikat e trajtuara nga Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore:

QTTB Vlorë

- Përmirësimi i kushteve ekonomike në zonat rurale përmes rritjes së produktivitetit dhe krijimit të vendeve të reja të punës;
- Shfrytëzimi i produkteve bujqësore të prodhuara në fermë për agroturizëm;
- Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit në fermë nga gratë.

QTTB Lushnjë

- Agroturizmi dhe roli i gruas në zonat rurale;
- Teknologjitë e kultivimit të perimeve në serra;
- Trajtimi i perimeve pas vjeljes në kushtet e fermës;
- Ruajtja dhe konservimi i perimeve në kushtet e fermës;
- Kultivimi i perimeve autoktone në serra;
- Kultivarët e rinj të grurit, cilësitë dhe vlerat teknologjike.

QTTB Shkodër

- Diversifikimi i kultivimit të BAM. Përfshirja në kultivim dhe teknikat për disa bimë me interes ekonomik në këtë sektor (Bari i bletës, Lule Basani, Mentha peperita);
- Rëndësia dhe teknikat e tharjes së BAM, në funksion të ruajtjes së cilësisë dhe standarteve të prodhimit;
- Teknologjia e kultivimit të livandës për distilim, mekanizimi i proceseve etj.

QTTB Korçë

- Përpunimi artizanal i mollës në kushtet e shtëpisë dhe shtimi i vlerës së produktit;
- Agroteknika e prodhimit organik të patates dhe pjesëmarrja e grave në aktivitet prodhues;
- Zinxhiri i vlerave të prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij;
- Prodhimi dhe përpunimi i produkteve blegtorale.

Grupi i ngritur me qëllim monitorimin e procesit adresoi këto çështje:

- Dhënie informacioni mbi politikat dhe projektet e zhvillimit të agroturizimit;
- Njohje me projektet që po punojnë në MBZHR, të cilët adresojnë problematikat lidhur me produktet tradicionale, lidhjen me agroturizimin, si dhe inkubatorët e prodhimit;
- Mundësimi i një fondi të dedikuar për bashkitë për rivitalizimin e tregjeve tradicionale që do të shërbejnë dhe për promovimin e produkteve turistike;

- Adresimi tek AREB-et për marrje informacioni në kohë reale, lidhur me mundësitë e pjesëmarrjes në aktivitete promovuese;
- Nxitja për pjesëmarrje aktive të grave në aplikimet në skemat e mbështetjes kombëtare.

Numri i pjesëmarrëseve në këto aktivitete ishte 380 gra fermere të zonave ku u zhvilluan trajnimet nga 500 të planifikuara, pasi për arsye objektive nuk u realizua trajnimi i planifikuar nga QTTB Fushë Krujë.

5. **Programi 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrimi”**

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2024, për këtë program, që përfaqëson 3.41% të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|--------|
| • Shpenzimet korrente | 96.9 % |
| • Shpenzimet kapitale | 95.6 % |

Gjithsej	96.9%
-----------------	--------------

Në programin buxhetor “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, përfshihet financimi për pagat e punonjësve të aparatit të MBZHR-së, për trajnimet e nëpunësve, për përmirësimin e strukturës funksionale të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kapaciteteve menaxhuese dhe implementuese në institucion, në funksion të hartimit dhe monitorimit të politikave.

Produktet e parashikuara të këtij programi buxhetor janë realizuar si vijon:

Produkti: 90501AA Akte ligjore dhe nënligjore të miratuara (Puna e stafit të ministrisë për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore)

Ky produkt i parashikuar në vlerën 302,660,000 lekë, i rishikuar, për vitin 2024 është realizuar në vlerën 302,660,000 lekë, në masën 99%, pasi nuk u plotësuan për këtë periudhë të gjitha vendet vakant që u krijuan gjatë vitit.

Produkti: 90501AB Institucion në mirëfunksion (Kapacitetete menaxhuese dhe implementuese në institucion dhe mirëfunktionale për hartimin dhe monitorimin e politikave).

Ky produkt i parashikuar në vlerën 95,980,000 lekë, i rishikuar, për vitin 2024 është realizuar në vlerën 89,139,204 lekë, në masën 93%, pasi u planifikua pagesa për shlyerjen e detyrimeve të arbitrazhit ndërkombëtar çështja Valeria SRL, por çështja u fitua nga MBZHR dhe për këtë arsye fondi i planifikuar nuk u realizua.

Produkti: 90501AC Personel i trajnuar (Aftësi në rritje të stafit përmes trajnimeve të ndryshme të nevojshme për realizimin e detyrave funksionale).

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore të afta për implementimin e politikave ekzistuese, si dhe të mirëtrajnuara për t'ju përshtatur proceseve integruese ishin planifikuar për t'u realizuar 163 trajnime në drejtim të arritjes së standarteve të sigurisë ushqimore, zhvillimit rural, ujitjes dhe kullimit etj. Gjatë vitit 2024 janë realizuar 190 trajnime nga stafi i institucionit.

Ky produkt i parashikuar në vlerën 15,000,000 lekë, i rishikuar, për vitin 2024 është realizuar në vlerën 12,679,767 lekë, në masën 85%. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe personeli i MBZHR-së ka ndjekur trajnimet pranë ASPA-s apo institucioneve të tjera, të cilat nuk janë me pagesë.

Produkti: 90501AD Pagesë për kuotat ndërkombëtare të realizuara

(Për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucionit nevojitet pjesëmarrja në takime vjetore ndërkombëtare, trajnime, Workshope, të cilat kërkojnë shpenzime për kuota anëtarësimi në organizma ndërkombëtare).

Republika e Shqipërisë aderon në disa organizata ndërkombëtare me të cilat ka lidhur edhe marrëveshje. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve MBZHR ka detyrime për përmbushjen e 12 kuotave financiare për pjesëmarrjet ku ajo aderon.

Ky produkt i parashikuar në vlerën 40,000,000 lekë, i rishikuar, për vitin 2024 është realizuar në vlerën 39,178,254 lekë, në masën 98% dhe diferencat me 2% mosrealizim, vijnë nga kurset e këmbimit valutor, pasi pagesat kryhen në valutë.

Produkti: Kodi 90501AE Institucione të audituara (Auditimi i institucioneve të varësisë së MBZHR-së).

Referuar planit të auditimeve, për vitin 2024 janë planifikuar për auditim 17 institucione. Për periudhën e vitit 2024 ky produkt i planifikuar në vlerën 3,000,000 lekë, i rishikuar, për vitin 2024 është realizuar në vlerën 2,794,000 lekë, në masën 93%.

Produkti: Kodi 18AI901 Blerje pajisje kompjuterike për aparatin e MBZHR

Ky produkt i parashikuar në vlerën 2,100,000 lekë, i rishikuar, është realizuar në vlerën 2,040,000 lekë, në masën 97%.

Procedura për blerjen e pajisjeve kompjuterike për aparatin e MBZHR-së është realizuar brenda kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor (MBZHR).

Diferenca ka ardhur nga fondi limit, pasi Operatori Ekonomik fitues ka sjellë ofertën nën fondin limit të përcaktuar në procedurën e prokurimit.

Produkti: Kodi M050466 Blerje pajisje zyrash për aparatin e MBZHR

Ky produkt i parashikuar në vlerën 1,000,000 lekë, i rishikuar, është realizuar në vlerën 924,000 lekë, në masën 92%.

Procedura për blerjen e pajisjeve të zyrave për aparatin e MBZHR-së është realizuar brenda kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor (MBZHR).

*****Për këtë produkt në AFMIS nuk gjenerohet Kodi përkatës (M050466) dhe për këtë arsye del me mangësi nga plani në SIFQ në vlerën 1,000,000 lekë. Si rrjedhojë edhe realizimi për këtë produkt del me diferencë në vlerën 924,000 lekë.*****

6. Programi 04230, “Menaxhimi i Peshkimit”

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2024, për këtë program, që përfaqëson **1.86%** të buxhetit faktik të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korrente	96.2%
• Shpenzimet kapitale	99.1 %
• Gjithsej	97.1%

Politikat në fushën e peshkimit janë në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE dhe të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit me fokus zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit, përcaktimin e rregullave për menaxhimin dhe bashkëmenaxhimin e sektorit të peshkimit dhe të porteve dhe qendrave të peshkimit, zbatimin e një politike strukturore dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

Programi buxhetor “Mbështetje për Peshkimin”, për vitin 2024 ka në dispozicion gjithsej 249,735,000 lekë, nga të cilat:

- Shpenzime korrente 114,600 mijë lekë, dhe
- Shpenzime kapitale 135,135 mijë lekë

Gjatë viti 2024 janë kryer një sërë aktivitete në drejtim të plotësimit të objektivave të programit, ndër të cilat rendisim:

- Menaxhimi i porteve Shëngjin, Vlorë, Sarandë e Durrës dhe të tre ekonomive Zvezdë, Lin e Butrint.
- Janë kryer kontrolle e inspektime në zbatim të Ligjit të Peshkimit Nr.64/2012 dhe të Rregulloreve përkatëse për një shfrytëzim sa më të mirë të burimeve peshkore.
- Për krijimin e një tregu funksional të shitjes me shumicë të peshkut dhe ngritjen e sistemit të informacionit për tregtimin e peshkut ka përfunduar ndërtimi i tregut të tregtimit të peshkut në Shëngjin, ndërsa është në proces zbatimi ndërtimi i tregut të Vlorës.

Produktet e përfituara për vitin 2024, parashikuar për PBA-në e vitit 2024, janë realizuar si më poshtë:

Produkti 90503AA: Infrastruktura portuale e mirëmanaxhuar.

Plani për vitin 2024: 138.235 mijë lekë	Fakti për vitin 2024: 132.254 mijë lekë
---	---

Buxheti për këtë produkt është një proces në vazhdimësi për të katër portet e peshkimit: në Durrës, Shëngjin, Vlorë dhe Sarandë dhe të tre ekonomive Zvezdë, Lin e Butrint.

Produkti 90503AB: Kontrollat e inspektoratit të peshkimit në subjektet e peshkimit:

Plani për vitin 2024: 15.000 mijë lekë	Fakti për vitin 2024: 14.779 mijë lekë
--	--

Gjatë periudhës së raportimit janë kryer 2259 kontrole dhe inspektime të vazhdueshme në lidhje me zbatimin e kushteve të vendosura në lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit si në det dhe në ujërat e brendshme dhe akuakulturës. Prioritet ka qenë inspektimi në vijën bregdetare për parandalimin e evidentimin e gjuetisë së paligjshme. Gjithashtu janë kryer kontrole e inspektime në det, në ujërat e brendshme, në pikat e tregtimit dhe magazinimit të produkteve peshkore, etj.

Produkti 90503AD: Raporte të kryera për një monitorim sa më të saktë të aktiviteteve të lidhur me peshkimin, akuakulturën dhe molusqet.

Plani për vitin 2024: 3.500 mijë lekë	Fakti për vitin 2024: 3.499 mijë lekë
---------------------------------------	---------------------------------------

Produkti 90503AF: Ripopullim me rasate për pasurim të resurseve peshkore

Plani për vitin 2024: 13.000 mijë lekë	Fakti për vitin 2024: 12.834 mijë lekë
--	--

Ky produkt ka për qëllim ripopullimin me rasate për rritjen e rezervave peshkore. Gjatë vitit 2024, është bërë blerja e bazës material, ushqim rasati, grumbullim veze, etj.

Produkti 21AC709: Implementimi i sistemit ERS

Plani për vitin 2024: 70.000 mijë lekë	Fakti për vitin 2024: 70.000 mijë lekë
--	--

Implementimi i Sistemit të Raportimit Elektronik të të dhënave (ERS) në peshkim është një sistem që regjistron, raporton, përpunon, ruan dhe transmeton të dhënat e peshkimit (zënie, zbarkim dhe transbordim). Regjistrimi dhe raportimi elektronik i të dhënave të peshkimit ka për qëllim të forcojë efektivitetin e operacioneve të monitorimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes si në det ashtu edhe në tokë. Ky sistem ngrihet në zbatim të VKM nr. 756

datë 1.12. 2022 “Për mënyrën e ngritjes dhe funksionimit të sistemit elektronik të regjistrimit dhe raportimit të aktivitetit të peshkimit dhe përcaktimin e kohës për vënien në funksion të tij”. Për këtë projekt është lidhur kontrata me shtrirje në tre viti 2024-2026 dhe është disbursuar fondi i akorduar për vitin 2024.

Produkti M051219: Blerje automjete

Plani për vitin 2024: 9.000 mijë lekë	Fakti për vitin 2024: 8.760 mijë lekë
---------------------------------------	---------------------------------------

Blerje automjete për përdorim nga administrata e DSHPA.

Produkti M051212: Pajisje elektronike

Plani për vitin 2024: 1.000 mijë lekë	Fakti për vitin 2024: 489.643 lekë
---------------------------------------	------------------------------------

Blerje pajisjesh elektronike për përdorim nga administrata e DSHPA.

7. Programi 05470, “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2024, për këtë program që përfaqëson rreth **0.1 %** të realizimit të buxhetit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|-------------|
| • Shpenzimet korrente | 97.5 % |
| • Gjithsej | 13 % |

Programi “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore” i cili synon të krijojë Sistemin e Informacionit për Tokën (LIS) në rreth 12 000 ha tokë bujqësore në njësitë administrative Bashkinë Dibër, Peshkopi, njësitë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin për vitin 2024 janë realizuar detyrat e mëposhtme:

1. Inventarizimi dhe klasifikimi i tokave bujqësore sipas përshtatshmërisë së saj.

- Skanimi dhe gjeoreferencimi i hartave topografike ushtarake me shkallë 1:25 000.
- Përcaktimi i volumeve të punës të cilat janë kryer në terren (sondimet e tokës) për njësinë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin, bashkia Dibër.
- Rikonicioni i zonave në njësinë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin, bashkia Dibër.
- Studimi fushor (sondimet e tokës) për mbledhjen e të dhënave mbi karakteristikat e dheut, vendit dhe klimës përcaktuese në përshtatshmërinë e tokës në njësitë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin, respektivisht janë kryer 360 dhe 380 sondime,

- Përcaktimi i tipeve të tokës bujqësore për njësitë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin.
 - Hapja dhe përshkrimi i profileve në tipet kryesore të tokës bujqësore për njësitë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin, total 16 profile toke.
 - Krijimi në excel i bazës së të dhënave për tokën dhe dheun të mbledhura në terren për njësitë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin janë përfunduar 740 skeda.
2. Mbledhja e informacionit për përdorimin/mbulesë tokësore për vitin që është kryer regjistrimi fillestar dhe 2024 si dhe analizimi i dinamikës së ndryshimeve në përdorimin e tokës bazuar te parcela.
- Përgatitja e bazës materiale (orthophoto) për verifikimin e përdorimit të tokës në terren.
 - Hedhja e përdorimit/mbulesës tokësore nëpërmjet interpretimit të orthophotove dhe verifikimeve në terren në njësitë administrative Maqellarë dhe në Qendër Tomin.
 - Dixhitalizimi i rrjetit rrugor për njësitë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin.
 - Dixhitalizimi i ndërtimeve nëpërmjet interpretimit të orthophotove për njësitë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin.
3. Studimi agro-ekologjik i zonave në studim.
- Përgatitja e pyetësorëve agro-ekologjik për njësitë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin.
 - Marrja e mostrave të ujit në burimet kryesore që përdoren për ujitje për njësinë administrative Maqellarë dhe Qendër Tomin.
4. Dixhitalizimi i regjistrit të tokës bujqësore.
- Dixhitalizimi i regjistrave bujqësore për njësitë administrative Koplik, Shkrelë, Qendër Malësi e madhe Qarku Shkodër dhe njësia administrative Divjakë Qarku Fier
5. Krijimi i programit WEB-GIS për të dhënat e tokës
- Azhornimi i të dhënave për tokën për 21 njësi administrative Bashkinë Lushnje, Vlorë, Finiq, Kuçovë, Berat dhe Kolonjë, Delvinë, Roskovec të përfunduara dhe 79 njësi administrative janë në proces.
6. Emergjencat
- Janë përfunduar trajnimet në kuadër të Emergjencave nga Zjarret, Digat dhe Erozioni në strukturat e Qarqeve Lezhë, Vlorë dhe Korçë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

	05470	Plan	Shpenzuar si 12 mujor fakt
QTTB Fushë Krujë	Krijimi LIS/GIS nga QTTB Fushë Krujë	6,851,704	6,523,410
	Sistemi i informacionit mbi tokën LIS i plotësuar dhe integrimi në GIS.	6,148,296	6,148,296
	Dixhitalizim RTB	300,000	300,000
	Shuma	13,300,000	12,971,706

Realizimi 12-mujor për vitin 2024 i shpenzimeve për këtë program është 97.5%.

Në fillim të vitit 2024, fondi në planin fillestar për programin 05470 ishte parashikuar 25,000,000 lekë. Fondi prej 1,000,000 lekë ishte lënë në Aparatin e MBZHR-së, në të njëjtin program 05470 për emergjencat civile dhe gjithashtu, 9,000,000 lekë ishin parashikuar për mirëmbajtjen e WEB-GIS i cili gjatë vitit u hoq me Akt Normativ duke qenë se ky shërbim kryhet nga AKSHI. Lidhur me fondi prej 1,700,000 lekë i cili nuk u realizua për vitin 2024, është krijuar nga teprica e prokurimeve.

Realizimi faktik për 12-mujorin e vitit 2024 është në vlerën 12,971,706 lekë për integrimin e LIS në GIS për 12000 ha tokë bujqësore, për QTTB-në Fushë-Krujë.

❖ Situata e Detyrimeve të Prapambetura

Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar ka monitoruar detyrimet e prapambetura të institucioneve zbatuese dhe në datën 31 Dhjetor 2024, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rezulton që Institucionet tona të varësisë, kanë vetdeklaruar në Degët e Thesarit, detyrime të prapambetura si më poshtë:

- Për Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Durrës, për shumën 9,997,040 lekë, si detyrim të prapambetur për punimet e kryera në investimin me objekt “Mbrojtje lumore nga gërryerjet në lumin erzen, Ibe e poshtme (fshati Shkalle)”.
- Për Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Korçë, për shumën 79,432,318 lekë, si detyrim të prapambetur për punimet e kryera në investimet me objekt:
 - “Mbrojtje nga gërryerjet dhe përmytja nga lumi Osum, në Starovë - Remanicë”;
 - “Mbrojtje nga lumi Shkumbin në Fatisht, Bashkia Peqin”;
 - “Rehabilitim vepra e marrjes + skema ujitëse, Naum Panxhi”

Këto detyrime do të likuidohet në 4 mujorin e parë të vitit 2025.

❖ Produktet dhe politikat qjinore

Në vijimësi nga vitet e kaluara, është mbajtur parasysh zbatimi i VKM-së nr. 465, datë 18.7.2012, “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”, duke përcaktuar në objektiva si dhe në tregues performance, produktet që i përkasin çështjeve të barazisë gjinore, ku në programin buxhetor “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor”, Qëndrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, dhe në programin e dytë “Zhvillimi Rural”.

- Për programin 04250; gjatë vitit 2024, referuar indikatorit “Numër përfituesish burra dhe gra nga IPARD janë financuar disbursuar 40 subjekte, nga të cilat 11 janë gra.
- Përsa i përket indikatorit “Numër përfituesish burra dhe gra nga Skemat Kombëtare”, për vitin 2024 nga 14.937 përfitues nga skema kombëtare, nga të cilat 2,425 janë gra. Gjithashtu nga 52,195 përfitues të skemës së subvencionimit me naftë për bujqësinë, 5,043 janë gra.
- Për programin 04860; gjatë vitit 2024 janë realizuar 1,538 mijë lekë nga produkti “*Gra të informuara dhe trajnuara nga shërbimi këshillimor publik*” që ka të bëjë me barazinë gjinore. Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, për vitin 2024 realizuan 4 ditë trajnimi të dedikuara për 380 gra pjesëmarrëse, me synim zbutjen e parabarazisë dhe integrimin gjinor.

❖ Komente mbi sistemin AFMIS

Sa i përket sistemit AFMIS, u konstatuan se në programin “Planifikimi, Menadhimi dhe Administrimi”, nuk gjenerohet Kodi M050466 në Investimet e Brendshme dhe për këtë arsye anekset e gjeneruara kanë mangësi nga plani i çelur në SIFQ, në vlerën 1,000,000 lekë dhe si rrjedhojë dhe realizimi për këtë produkt ka diferencë në vlerën 924,000 lekë.

Gjithashtu, problematikë tjetër vazhdon të jenë diferencat në realizimin e Financimit të Huaj, konstatuar në programin “Zhvillimi Rural”, ku sipas situacioneve të raportuar nga institucionet tona (AZHBR), realizimi për projektin me kod 18AL303 “*Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 3 (7)*” paraqitet në shumën 21,278,084 lekë më shumë se në sistemin AFMIS (356,597,430 lekë në sistemin AFMIS, 377,875,514 lekë raportuar nga AZHBR).

Problematikë tjetër është konstatuar dhe në projektin “*Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë*”, ku nuk janë përfshirë shpenzimet Front&Fee dhe të tjera. (Realizimi i raportuar nga Banka Botërore 52,326 mijë lekë, realizimi në sistemin AFMIS 18,799 mijë lekë).

Planifikimi dhe Realizimi i të ardhurave

Për vitin 2024, në total për MBZHR-në janë parashikuar në PBA 274,568,000 lekë, janë realizuar të ardhura në vlerën 190,595,163 lekë. Janë përdorur në fakt 23,197,860 lekë nga 38,600,000 lekë të planifikuara në buxhet. Nëpërmjet të ardhurave dytësore institucionet zbatuese të MBZHR-së kanë derdhur në buxhetin e shtetit 164,953,718 lekë.